



Prishtinë, 04 tetor 2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1410\_2021

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 4406/9 ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej 27 kW në Komunën e Prishtinës, e pranuar me nr. Prot. 557/21 të datës 10.09.2021 nga aplikuesi "UNDP KOSOVO" në Prishtinë, me adresë: Rruga "Vicianum", Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 04 tetor 2021 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "UNDP KOSOVO" në Prishtinë, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e objektit në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 4406/9 ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej 27 kW, Komuna e Prishtinës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "UNDP KOSOVO" në Prishtinë, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR- 90088780 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrorj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "UNDP KOSOVO" në Prishtinë, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

**Arsyetim**



- ZRRE, me datë 10.09.2021 nga aplikuesi UNDP KOSOVO” në Prishtinë, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 4406/9 ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej 27 kW, Komuna e Prishtinës.
  - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 7753 të datës 10.08.2021 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 05-350/02-47025/21 i dt. 18.05.2021 të lëshuar nga Drejtoria Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit “UNDP KOSOVO” në Prishtinë, dhe dëshmive të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 4406/9 ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej 27 kW, Komuna e Prishtinës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Prishtinës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Pejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar